



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës:

Datë:

Numri i dokumentit:

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shpresa Emra, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsën Shoshani, në çështjen penale të akuzuarve H.S nga K, Punjabi, Republika e Indisë dhe A.K nga G, Punjabi, Republika e Indisë, për shkak se kanë kryer veprën penale kalimi i paautorizuar vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par. 1 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm..... të datës ....., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit Mehreme Hoxha, të akuzuarve, dhe mbrojtësit av. me datë ..... mori dhe shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### Të akuzuarit

**1.H.S**, nga i ati B, i lindur më ..... në K, Punjabi, shteti Indian, ku edhe jeton me adresë....., Republika e Indisë, i papunë i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar, identifikohet me pasaportë të Republikës së Indisë me nr. ....

**2.A.K** nga i ati M. dhe e ëma B, lindur me dt..... G, Punjabi, Republika e Indisë, ku edhe banon, në adresë....., e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, e pamartuar, identifikohet me pasaportë të Republikës së Indisë me numër.....

#### JANË FAJTOR

Se me datën....., rreth orës....., në vendin e quajtur “Liqeni i Vërmicës”, të pandehurit në bashkëveprim kalojnë kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës, në vendkalimin kufitar në Vërmicë, jashtë vijës kufitare, duke ecur në këmbë, gjë që të pandehurit janë hasur në afërsi të restorantit “.....” ku janë ndaluar ana e policisë kufitare të Kosovës.

**Me këto veprime kanë kryer veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KP-së.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 39,46,47,48,49, 69 dhe nenit 140 paragrafi.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, të akuzuari i gjykon dhe ju shqipton:

### **DËNIM ME BURGIM ME KUSHT**

Të akuzuarit të parë H.S, nga K, Punjabi, Republika e Indisë, i shqiptohet dënimi me burgim me kusht, duke iu vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje **prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi** në qoftë se i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarës së dytë A.K, nga G, Punjabi, Republika e Indisë i shqiptohet dënimi me burgim me kusht, duke iu vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje **prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi** në qoftë se e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Konform nenit 62 të KP-së, kundër të akuzuarve shqiptohet edhe:

### **DËNIMI PLOTËSUES**

#### **Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës**

**URDHËROHET** Policia e Kosovës që ti dëbojë të akuzuarit H.S, nga K, Punjabi, Republika e Indisë dhe A.K nga G, Punjabi, Republika e Indisë, menjëherë pas pranimit të aktgjykimit.

Të akuzuarit obligohen që t' i paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20€ dhe në emër të Fondit për kompensim të viktimave 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**REFUZOHET** propozimi për caktimin e paraburgimit ndaj të akuzuarve H.S, dhe A. K parashtruar nga ana e Prokurorisë me Aktakuzë.....

**URDHËROHET** Policia e Kosovës që të akuzuarve H.S, nga K, Punjabi, Republika e Indisë dhe A.K nga G., Punjabi, Republika e Indisë të ju ndërpritet ndalimi dhe t'i dëbojë nga territori i Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën....., me propozim për caktimin e masës së paraburgimit, kundër të akuzuarve, H.S, nga K, Punjabi, Republika e Indisë dhe A.K nga G, Punjabi, Republika e Indisë, për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KP-së

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku në shqyrtimin fillestar të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen .

Gjatë shqyrtimit fillestar gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në vijim: me datën .....rreth orës....., në vendin e quajtur “Liçeni i Vërmicës”, të pandehurit në bashkëveprim kalojnë kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës, në vendkalimin kufitar në Vërmicë, jashtë vijës kufitare, duke ecur në këmbë, gjë që të pandehurit janë hasur në afërsi të restorantit “.....” janë ndaluar ana e policisë kufitare të Kosovës,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë. Bazuar në faktin se të akuzuarit kanë pranuar vullnetarisht fajësinë, gjykata fare nuk është lëshuar në administrimin e provave.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme. Gjithashtu gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila ju vihet në barrë. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzime dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë ka qenë të njoftuar me të gjitha (provat materiale).

Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, ku bazuar në faktet që përmban aktakuza në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoi dënimin me burgim me kusht dhe dënimin plotësues dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e vendosjes mbi dënimin me kusht gjykata vlerësoi - mori në konsideratë të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-së. Respektivisht mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin. Gjykata gjatë vendosjes mbi dënimin gjeti se rrethanë lehtësuese është pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjelljen e tyre korrekte me organet e ndjekjes penale, pendimin e thellë për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kësi veprash penale, gjendjen e dobët ekonomike.

Andaj duke marr në konsideratë atë që u tha më lartë, gjykata konsideron se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi preventiv i dënimin, ku të njëjtëve (të akuzuarve) u shqiptoi secilit dënimin me kusht në kohëzgjatje prej nga 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohorë prej 1 (një) viti, nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepër të re penale dhe dënimin plotësues dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës. Gjykata, gjithnjë duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimin që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Gjykata e refuzoi propozimin e Prokurorisë së Shtetit për caktimin e Paraburgimit bazuar në nenin 367 të KP pasi që nuk janë përmbushur kushtet për caktimin e paraburgimit, respektivisht gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar dhe i ka gjykuar të akuzuarit si më lartë dhe me këtë kanë pushuar shkaqet për caktim të paraburgimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësorë, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të kompensimit të viktimave është bazuar në nenin 39 par.3-1 të Ligjit për Kompensim të viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**Gjyqtari**

---

**Shpresa Emra**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.